



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 21.22.1-2016-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË MINISTRISË SË
ZHVILLIMIT EKONOMIK PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31
DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Faruk Rrahmani (Udhëheqës ekipe) dhe Fatlinda Podvorica e Albesa Ramosaj (Anëtarë ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Emine Fazliu.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	22
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	23
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	26
Shtojca IV: Komentet e MZHE-së për të gjeturat e raportit të auditimit	29
Shtojca V: Letërkonfirmimi	31

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 25.10.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërdrejt cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar


Pasqyrat financiare vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Për më gjerësisht shih pjesën 1.1 të këtij raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Ministrin dhe stafin e tij mbështetës për bashkëpunimin e ofruar gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Ministrit**

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me pjesën më të madhe të të gjeturave të detajuara dhe konkluzionet e auditimit. Komentet për të cilat janë pajtuar pjesërisht apo nuk janë pajtuar mund t'i gjeni në shtojcën IV.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu, e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësi dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq - deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV dhe kërkesat tjera për raportim

Nga MZHE kërkohet të raportojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013 dhe Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë;
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€;
- Raportet për faturat e papaguara;
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit; dhe
- Raportet e kontratave të nënshkruara të prokurimit.

Të gjitha kërkesat për raportim si në kontekst të PVF-ve dhe raportimit të jashtëm ishin përmbushur dhe kishin një cilësi të mirë dhe ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Në PFV ishin të nevojshme disa korrigjime për të cilat kemi dhënë sugjerime për përmirësim. Pas sugjerimeve tona, MZHE kishte korrigjuar PFV-të, mirëpo edhe pas korrigjimit PFV-të përmbanin disa gabime jo materiale të cilat i kemi shpalosur në vijim:

- *Te neni 13 - shënimi 6, investime kapitale* - Buxheti dhe shpenzimi për projektin "Identifikimi i efekteve anësore të aktiviteteve minerare në komunitet", në vlerë prej 49,000€ ishte buxhetuar dhe realizuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale (kodi i pasurisë së paprekshme). Për nga natyra ky aktivitet i takon hulumtimit (studimit). Sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit nr.38² për pasuritë e paprekshme - shpenzimet e hulumtimit, studimit apo kërkimeve nuk kapitalizohen dhe nuk njihen si pasuri e paprekshme por ato duhet të klasifikohen si shpenzime operative; dhe
- *Te neni 19 - pasuritë jo kapitale* - vlera e pasurive neto nën 1,000€ ishte nënvlerësuar për 17,027€. Pasuritë jo kapitale ishin raportuar në vlerë 54,000€, përderisa vlera e tyre në

² Standardi Ndërkombëtarë i Kontabilitetit nr. 38: "të gjitha shpenzimet e studimit/hulumtimit duhet të klasifikohen si shpenzime operative dhe nuk duhet të kapitalizohen për arsye se është e pamundur të tregohet nëse do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen. Studimet janë në fazën fillestare të identifikimit të mineraleve e cila i përcakton mundësitë për investim."

regjistrin e pasurive ishte 71,027€. Po ashtu, saldot përfundimtare të vitit 2015 nuk ishin bartur saktë në PFV-të 2016 te kolona e vitit 2015.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

1.3 Rekomandimet

Për çështjen e theksuar te pajtueshmëria me kërkesat për PFV dhe kërkesat tjera për raportim ne japim rekomandimin si në vijim:

Rekomandimi 1 Ministri duhet të sigurojë se buxhetimi dhe klasifikimi i projekteve analizohen mirë dhe që ato duhet t'i takojnë kategorisë adekuate për të shmangur keq klasifikimin. Më tutje, Ministri duhet të siguroj raportim të saktë të pasurive jo kapitale nën 1,000€.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MZHE-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga MZHE siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në lidhje me qeverisjen e mirë ne vlerësojmë progresin e bërë nga MZHE në hartimin e listës së rreziqeve, e cila ishte bërë si një dokument fillestar. Megjithëse, ende ekzistojnë një numër i dobësive të qeverisjes brenda MZHE-së, veçanërisht në lidhje me moszbatimin e plotë të rekomandimeve nga viti paraprak, mungesën e një plani për menaxhimin e rrezikut, si dhe ndikimin e ulët të auditimit të brendshëm në rritjen e efikasitetit të kontrolleve të brendshme.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti jonë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 ka rezultuar me dhjetë (10) rekomandime. Prej tyre katër (4) janë zbatuar plotësisht, tri (3) janë në proces dhe tri (3) nuk janë zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë zbatuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 2 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura MZHE ka zbatuar kërkesat për të hartuar një plan veprimi brenda afatit kohor megjithatë, kjo nuk është mbështetur me një monitorim për zbatimin e plotë të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. MZHE ka bërë progres të kufizuar në adresimin e rekomandimeve, pasi që një numër i rekomandimeve ende nuk janë adresuar plotësisht. Rekomandimet e pa adresuara ndërlidhen me fushat, si: sistemi i auditimit të brendshëm, niveli i ulët i ekzekutimit të buxhetit të kapitalet si dhe, kompensimet për paga dhe mëditje nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Rreziku Vonesat në përmirësimet e kërkuara të proceseve operationale mund të ndikojnë në mos efikasitet të vazhdueshëm duke rezultuar në:

- Punë jo efektive të Auditimit të Brendshëm si një hallkë e rëndësishme e kontrollit të brendshëm;
- Nivel të ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimet kapitale; dhe
- Mbajtje të një numri të punësuarish jashtë listës së pagave.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për adresimin e tyre. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe dhe zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuar në MF, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MZHE më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-në në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

- MZHE kishte treguar progres në plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit në raport me vitin paraprak, megjithëse edhe me tutje menaxhimi i rrezikut nuk ishte bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara;
- Proceset strategjike konsiderohen si të vendosura. MZHE nuk ishte hartuar një strategji e përgjithshme, mirëpo kishte disa strategji sektoriale me objektiva të qarta strategjike. Po ashtu, kishte një proces të monitorimit të nivelit të arritur të përmbushjes së objektivave strategjike, përmes raporteve tremujore;
- Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga MZHE; dhe
- Auditimi i Brendshëm nuk i ka theksuar çështjet më lartë. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë nga MZHE për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetëvlerësimi i vitit paraprak ishte në progres.

Çështja 3 - Moszbatimi i plotë i kërkesave për menaxhimin e rrezikut – Prioritet i mesëm

E gjetura	Pyetësori i vetëvlerësimit i plotësuar nga MZHE ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut ishin në fazën fillestare. Ne vlerësojmë progresin, pasi që MZHE për herë të parë kishte hartuar listën e rreziqeve. Megjithatë, ne kemi vërejtur se nuk ishin ndërmarrë veprimet e nevojshme për hartimin e një plani për menaxhimin e këtyre rreziqeve si dhe veprimet konkrete në menaxhimin e tyre.
Rreziku	Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut ndikon në cilësinë dhe përmbushjen e objektivave pasi që rreziqet nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
Rekomandimi 3	Ministri duhet të sigurojë hartimin e planit për menaxhimin e rrezikut bazuar në rreziqet e identifikuara dhe të sigurojë raportim të rregullt për zbatimin e kërkesave në këtë fushë duke monitoruar menaxhimin e rreziqeve në vazhdimësi.

2.3 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm. Ne marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit (KA). Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe KA. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së dhe një auditor.

NjAB në Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2016, kishte planifikuar pesë (5) auditime të rregullta, një (1) me kërkesë dhe një (1) rreth zbatimit të rekomandimeve. Plani ishte hartuar në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe prioriteteve.

Çështja 4 - Mangësitë në sistemin e auditimit të brendshëm - Prioritet i lartë

E gjetura

Ekzistojnë disa çështje në lidhje me sistemin e auditimit të brendshëm:

- NjAB nuk kishte arritur të përmbushë planin vjetor të auditimit;
- Njëri prej raporteve (Auditimi për burimet njerëzore) ishte kontestuar nga njësia që ishte audituar;
- Njësitë e audituara pas raportit nuk kishin hartuar plane veprimi për zbatimin e rekomandimeve; dhe
- Raportimet në njësinë qendrore harmonizuese nuk ishin bërë në secilin tremujor.

NjAB në vitin 2016 kishte vepruar në një kontest të kundërthënies të brendshme brenda vetë NjAB-së, përfshirë këtu edhe KA-në dhe menaxhmentin. KA në takimet e mbajtura gjatë vitit nuk ishte i kënaqur me cilësinë e punës së bërë nga NjAB dhe kishte dhënë rekomandime të vazhdueshme për përmirësim. Në anën tjetër edhe udhëheqësja e NjAB-së kishte shpreh shqetësimin në lidhje me pengesat në procesin e përmbushjes së auditimeve. Të gjitha këto elemente kanë ndikuar që puna e NjAB-së të mos jenë efektive.

Rreziku

Dobësitë e evidentuara e zbehin punën efektive të NjAB-së dhe rrisin rrezikun që kontrollet të jenë jo efikase në parandalimin e mangësive në aktivitetet operative të MZHE-së. Kjo mund të rezultojë me vazhdimin e praktikave joefektive dhe përsëritjen e mangësive të njëjta.

Rekomandimi 4

Ministri duhet të analizojë shkaqet e mosfunksionimit efektiv të NjAB-së dhe të ndërmerr veprimet që ndikojnë në eliminimin e pengesave në mes të akterëve relevant, duke funksionalizuar NjAB-në si një komponent shumë i rëndësishëm i kontrollit të brendshëm.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy (2), pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

MZHE ka kontrolle në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Në vitin 2016, ka përdorur 90% të buxhet final, përqindje pothuajse e njëjtë me atë të vitit paraprak. Në përgjithësi MZHE kishte një performancë të mirë buxhetore, më përjashtim të investimeve kapitale.

Megjithëse, një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë: menaxhimi më efikas i proceseve të prokurimit, monitorimi i subvencioneve dhe transfereve kapitale të Ndërmarrjeve Publike përfshirë Trepçën si dhe buxhetimi dhe klasifikimi i pasurive në kategoritë adekuate.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	31,485,094	32,275,883	29,011,107	23,609,109	26,518,897
Granti i Qeverisë -Buxheti	27,490,094	28,215,883	28,166,408	22,097,977	26,015,230
Financimet nga Huamarrjet	3,995,000	4,060,000	844,699	1,473,723	0
Donacionet e jashtme	0	0	0	37,409	503,667

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 790,789€. Rritja ka ndodhur pas rishikimit të buxhetit me vendime të Qeverisë.

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Në vitin 2016, MZHE ka shpenzuar 29,011,107€, apo 90% të buxhetit. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale të buxhetit për secilën kategori.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	31,485,094	32,275,883	29,011,107	23,609,109	26,518,897
Pagat dhe Mëditjet	1,081,345	1,110,351	1,073,641	947,753	875,000
Mallrat dhe Shërbimet	3,763,669	3,106,559	3,036,043	3,728,096	3,115,134
Shërbimet komunale	46,210	33,994	22,341	43,144	42,593
Subvencionet dhe Transferet	9,433,870	10,802,649	10,802,604	9,831,120	14,984,691
Investimet Kapitale	17,160,000	17,222,330	14,076,478	9,058,996	7,501,479

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Me vendime të Qeverisë kategoria e pagave dhe mëditjeve ishte rritur për 29,006€. Në raport me vitin paraprak shihet që kishte rritje të shpenzimeve për paga dhe mëditje për 125,888€. Kjo ishte rezultat i rritjes së numrit të punësuarve për 16 pozita me vendim të qeverisë nr. 06/39 të datës 22.07.2015 për integrimin e mbrojtjes civile në Mitrovicën e veriut. Po ashtu, ndikim më të vogël kishte edhe aplikimi i përvojës së punës;
- Me rishikim të buxhetit kategoria mallra dhe shërbime ishte zvogëluar për 896,129€, më pas me vendim të Qeverisë buxheti ishte rritur për 239,019€. Buxheti i kësaj kategorie ishte realizuar me 98%;
- Me vendim të Qeverisë buxheti i kategorisë së shërbimeve komunale ishte zvogëluar për 12,206€. Shpenzimet kishin të bënin me mbulimin e shërbimeve komunale për aeroportin e Gjakovës dhe disa nënstacione tjera. Megjithatë, një shumë e mjeteve prej 11,653€ kishte mbetur e pa shpenzuar;
- Me rishikim të buxhetit kategoria e subvencioneve ishte rritur për 439,533€, ndërsa më pas me vendime të Qeverisë ishte rritur edhe për 929,246€. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 100%; dhe
- Te investimet kapitale me rishikim kishte rritje të buxhetit për 87,274€, kurse pas rishikimit me vendime të Qeverisë buxheti ishte zvogëluar për 24,944€. Rreth 82% e buxhetit të IK ishte shpenzuar, që paraqet një shkallë jo të kënaqshme. Deri sa fondet e ndara për NP-të ishin shpenzuar rreth 98%, te projektet e MZHE-së niveli i shpenzimeve ishte mjaft i ulët.

Çështja 5 – Realizimi i ulët i buxhetit për investime kapitale - Prioritet i lartë

E gjetura Realizimi i buxhetit të projektet kapitale edhe këtë vit ishte sfidë e MZHE-së. Projekti për efikasitet elektrik (Renovimi i pesë ndërtesave) i buxhetuar në vlerë prej 3,167,000€ ishte shpenzuar vetëm 223,191€ apo 7%. Ky projekt ka ndikuar që përqindja e investimeve kapitale në nivel të përgjithshëm të jetë e ulët. Prokurimi për këtë projekt kishte zgjatur 15 muaj deri të lidhja e kontratës (korrik 2015 - tetor 2016).

Fillimisht ky projekt ishte planifikuar të financohej nga huamarrja⁴ prej Bankës Botërore. Për menaxhimin e projektit ishte vendosur që të respektohen rregullat e prokurimit të cilat rrjedhin nga Ligji i Prokurimit Publik, si dhe rregullat e prokurimit të Bankës Botërore. Procesi ishte përcjellë me shumë ankesa nga operatorët dhe mospajtime në mes Bankës Botërore, MZHE-së dhe OSHP-së. Në fund si pasojë e këtyre mospajtimitve Banka Botërore e kishte shpallur si prokurim të dobët dhe kishte refuzuar që ky projekt të financohet nga fondet e saj. Me pas, ishte vendosur që kontrata e lidhur në vitin 2016 të financohej nga buxheti i Qeverisë së Kosovës, kurse fazat tjera do të financohen sipas marrëveshjes për huamarrje.

Rreziku Mos definimi me kohë i rregullave të prokurimit që duhet zbatuar ka sjellë në një situatë që financimi i projektit prej bankës botërore të rrezikohej dhe të dështojë realizimi i kësaj pjese të projektit. Mos realizimi i projekteve të rëndësishme kapitale ka ndikuar në nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit dhe shfrytëzimin joefikas të burimeve në sektorin publik.

Rekomandimi 5 Ministri, duhet të siguroj se është bërë një vlerësim i arsyeve në lidhje me pengesat e hasura në procesin e realizimit të këtij projekti, si dhe të nxjerrin mësimet në mënyrë që praktikatat e tilla të mos përsëriten. Në rastet e financimeve nga huamarrja ose forma tjera të bashkëfinancimeve duhet të përcaktohen qartë kërkesat për menaxhimin e projekteve.

⁴ Marrëveshja e Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Botërore për huamarrje në vlerë prej 31 mil. Dollar. Sipas marrëveshjes do të financohet "Projekti i Eficiencës" i cili është projekt afat gjatë dhe do të realizohet në disa faza.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave të MZHE-së.

Numri i aprovuar i të punësuarve në MZHE ishte 173, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 161 punonjës. Ne kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PFV.

Çështja 6 - Të punësuarit jashtë listës së pagave - Prioritet i lartë

E gjetura Me Rregulloren nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave është përcaktuar numri i këshilltarëve që mund të angazhojë çdo ministër dhe zëvendës ministër. Me ligjin e buxhetit 2016, Kabineti i Ministrit kishte të planifikuar 18 punëtorë. Në vitin aktual në kabinetin e ministrit ishin të punësuar 22 persona ku 17 prej tyre paguheshin nga lista e pagave ndërsa pesë (5) zyrtarë me kontrata të rregullta paguheshin nga kategoria mallra dhe shërbime.

MZHE kishte tejkalluar numrin e stafit të lejuar për kabinetin e ministrit për katër (4) pozita. Pagesa e zyrtarëve që kanë marrëdhënie të rregullt pune nga kategoria mallra dhe shërbime është në kundërshtim me nenin 11 të ligjit të buxhetit 05/L-071 dhe nenin 33 të rregullës së thesarit 01/2013, ku theksohet se të gjithë të punësuarit duhet të paguhen nga lista e pagave.

Rreziku Tejkalimi i numrit të punësuarve nga numri i buxhetuar dhe pagesa e tyre nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ndikon që buxheti nga kjo kategori të shpenzohet për qëllime tjera të paplanifikuara. Kjo rrezikon përmbushjen e objektivave të synuara me buxhetin e planifikuar.

Rekomandimi 6 Ministri duhet të sigurojë se respektohet korniza ligjore në lidhje me numrin e stafit të lejuar me buxhet dhe të gjithë zyrtarët që kanë kontrata të rregullta duhet të paguhen nga lista e pagave.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte shpenzuar rreth 98%. Shpenzimet më të mëdha nga kjo kategori kanë të bëjnë me pagesat për këshilltarin e transaksionit për termocentralin "Kosova C", mbrojtjen nëpër gjykatat e arbitrazhit dhe shpenzimet operative tjera. Bazuar në testet tona shpalosëm çështjen në vijim.

Çështja 7 – Pagesa për artikuj që nuk ishin pjesë e kontratës – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Nga testimi i pagesës "Furnizim për zyre" në vlerë prej 3,129€, kemi vërejtur se disa artikuj në vlerë 710€ të cilët ishin pranuar dhe paguar nuk ishin të përfshirë në kontratë. Fatura ishte pranuar dhe certifikuar përkundër parregullsive në këtë proces.
- Rreziku** Pranimi dhe pagesa e mallrave jo në përputhje me kontratën rrit rrezikun që kontrollet e vendosura për të parandaluar këto mangësi nuk janë efektive, duke rezultuar në vlerë të ulët për paranë e shpenzuar.
- Rekomandimi 7** Ministri duhet të siguroj se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë efektive dhe parandalojnë çdo parregulsi para se të ndodhë pagesa. Një monitorim i vazhdueshëm i efektivitetit të kontrolleve të vendosura mund të sigurohet edhe nga NjAB-i.

3.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti për subvencione dhe transfere ishte 10,802,649€. Të gjitha fondet për këtë kategori ishin shpenzuar. Prej tyre 10,766,704€ ishin dhënë për Entitet Publike, ndërsa në vlerë 35,900€ për Entitete jo Publike. Subvencionet për Entitete publike jepen bazuar në ndarjen buxhetore dhe vendimet e Qeverisë, përderisa për Entitete jo Publike jepen me vendim të Ministrit dhe nuk ka ndonjë rregullore e cila i definon kriteret e dhënies së tyre.

Çështja 8 – Pagesa e subvencionit nuk është në përputhje me marrëveshjen - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Pagesa e subvencionit në vlerë prej 20,000€ e bërë për Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" në Mitrovicë (pjesa e Veriut) për tre mujorin e dytë edhe pse ishte buxhetuar dhe shpenzuar nga nënprogrami "Ujë dhe hedhurina", nuk ishte realizuar në përputhje me Marrëveshjen për Monitorim dhe Kontroll, e lidhur në mes MZHE-së dhe NP "Uniteti".
- Në nenin 5 pika 1.1 e Marrëveshjes theksohet se pagesa e subvencionit do të kryhet pasi kërkesa e NP-së të jetë arsyetuar dhe të merr miratimin nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NjPMNP) në MZHE. Pagesa ishte realizuar pa u marrë miratimi nga ana e NjPMNP në kuadër të MZHE-së.

-
- Rreziku** Anashkalimi i miratimit nga NjPMNP e cila është e themeluar për këtë qëllim rrit rrezikun për kryerjen e pagesave të parregullta dhe mund të ndikojë në keq menaxhimin e mjeteve buxhetore.
- Rekomandimi 8** Ministri duhet të sigurojë se çdo pagesë për subvencion ka marrë aprovimin paraprak nga NjPMNP dhe është në përputhje të plotë me marrëveshjen e nënshkruar për monitorim.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti për investime (transfere) kapitale ishte 17,222,330€. Prej tyre ishin shpenzuar 14,076,478€ apo 82%. Shpenzimet më të mëdha nga kjo kategori kanë të bëjnë kryesisht me transferet kapitale për NP-të dhe Trepçën.

Çështja 9 – Kriteret e vendosura në dosje të tenderit – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Në njoftimin për kontratën “Identifikimi i efekteve anësore të aktiviteteve minerare në komunitet” si kriter për kapacitetet ekonomike dhe financiare ishin kërkuar të hyrat e tri viteve (2012-2014) mirëpo nuk ishte kërkuar viti i fundit 2015. Neni 68 i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) thekson se kërkesat për gjendjen ekonomike duhet të referohen maksimum në tri vitet e fundit.
- Rreziku** Vendosja e kriterëve në kundërshtim me ligjin dhe mos specifikimi i qartë për përmbushjen e kriterëve rritë rrezikun që të shpërblehen me kontratë operatorët të cilët nuk i përmbushin kriteret.
- Rekomandimi 9** Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit se kriteret e vendosura janë në përputhje të plotë me LPP-në dhe të specifikohen qartë dëshmitë që mund të përmbushin kriteret e përcaktuara.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrit kontabël të SIMFK-së, vlera neto e pasurive kapitale ishte 11,873,388€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale 71,027€.

Ne kemi testuar pasuritë që rrjedhin nga investimet kapitale gjatë vitit 2016, si dhe rregullsinë në evidentimin e pasurisë në dispozicion. Ne kemi bërë edhe ekzaminimin fizik për të verifikuar ekzistencën e pasurisë.

Auditimi jonë mbi menaxhimin e pasurisë identifikoi çështjet në vijim:

Çështja 10 - Mangësi në menaxhimin dhe raportimin e pasurive - Prioritet i mesëm

E gjetura Sistemi i e-pasurisë nuk e kishte kalkuluar zhvlerësimin e pasurisë jokapitale dhe MZHE nuk kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme për të kërkuar që ky problem të evitohet me kohë. Zyrtari i pasurisë kishte kalkuluar zhvlerësimin në excel ku edhe mund të rrjedhin gabime. Si pasojë e kësaj në PVF vlera e pasurive neto nën 1,000€ ishte nënvlerësuar për 17,027€. Pasuritë jo kapitale ishin raportuar në vlerë 54,000€, kurse sipas regjistrit të pasurive ne vërejtëm se vlera e tyre ishte 71,027€.

Gjatë vitit aktual për laboratorin e shërbimit gjeologjik ishin blerë pajisje në vlerë prej 583,985€. Ne verifikuam se gati gjysma e pasurive të blera ende nuk ishin funksionalizuar dhe ishin të paketuara në mungesë të kushteve dhe hapësirave adekuate.

Rreziku Evidencat jashtë sistemit e-pasuria mund të gjenerojnë informata jo të sakta dhe rrisin rrezikun që pasuritë të nënvlerësohen ose mbivlerësohen dhe prezantimi i vlerës së tyre në PFV të mos jetë i saktë. Në anën tjetër mbajtja e pasurive të blera jashtë funksionit përveç mos shfrytëzimit të tyre rritë rrezikun që edhe periudha e garancionit të skadoj, dhe si pasojë prishjet eventuale të mos evitohen pa kosto shtesë në periudhën e garancionit.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të sigurojë që menaxhimi i regjistrave të bëhet konform rregullave të përgjithshme për menaxhimin e pasurive, përkatësisht të sigurojë funksionalizimin e sistemit e-pasuria. Po ashtu, Ministri duhet të ndërmerr veprime që të krijohen kushtet që pajisjet për laboratorin e gjeologjisë të hyjnë në funksion.

3.3 Obligimet

Pasqyra e faturave të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 64,000€, përderisa ajo në fund të 2015 ishte 130,000€. Pra kishte një zvogëlim të obligimeve për 50% krahasuar me vitin paraprak. Obligimet e mbetura ishin si rezultat i mungesës së mjeteve dhe pranimi me vonesë të faturave. Raportimet e obligimeve janë kryer në kohën e duhur dhe përmbanin informata të plota.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që në vazhdimësi mbanë llogaridhënës personat përgjegjës të përcaktuar në planin e veprimit me qëllim të implementimit të rekomandimeve të AP-së sipas afateve kohore të përcaktuara me plan.		Nga 10 rekomandimet e dhëna katër janë zbatuar plotësisht kurse të tjerat janë ose në proces ose nuk janë zbatuar.	
2.4. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Ministri duhet të iniciojë hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të MZHE-së, përcjellë me koston financiare që mund të ndikojë në arritjen e objektivave të synuara duke u bazuar në strategjinë e përgjithshme të qeverisë. Po ashtu, duhet të ndërmerr veprime për adresimin e fushave me dobësi të identifikuara në listën kontrolluese të vetvlerësimit.			Nuk janë marrë masa.
2.5.1 Menaxhimi i rrezikut	Ministri duhet të sigurojë se regjistrat e rrezikut hartohen dhe shfrytëzohen nga menaxhmenti si mjete të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të tyre.	Po		
2.5.1 Sistemi i Auditimit të brendshëm	Ministri duhet të analizojë arsyen e përgatitjes me kohë dhe në mënyrë cilësore të planit vjetor dhe mos kryerjen e auditimeve nga NjAB-i si dhe të ndërmarrë masa për funksionalizimin e NjAB-it si pjesë e rëndësishme e kontrollit të brendshëm.			Nuk janë marrë masa.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të sigurojë se ka analizuar arsyet për mos realizimin e buxhetit për investime kapitale dhe transfere kapitale për NP në mënyrë sistematike gjatë vitit dhe të ndërmerr masa në bashkëpunim me NP-të që t'i eliminojë dobësitë qoftë në fazën e planifikimit ose ekzekutimit të buxhetit.		Projekti kapital për eficiencë elektrike ishte realizuar vetëm 7%,përderisa projektet tjera ishin realizuar mirë.	
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të sigurojë se planifikimi dhe klasifikimi i projekteve të caktuara bëhet duke pasur për bazë planin kontabël të aprovuar nga Ministria e Financave.		Ishte një studim i cili ishte klasifikuar si projekt kapital edhe pse si pasuri nuk ishte regjistruar.	
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri duhet të shtoj nivelin e kontrolleve mbi menaxhimin e shpenzimeve të telefonisë mobile për t'i racionalizuar ato. Në rastet e nevojës për tejkalime duhet të shqyrtohet mundësia e aprovimeve paraprake ose në të kundërtën të shqyrtohet mundësia e ndalesave nga paga.	Po		
3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të sigurojë që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave kanë vendosur të gjithë zyrtarët e punësuar që kanë marrëdhënie të rregullt pune në listën e pagave gjithnjë duke pasur parasysh numrin e aprovuar me ligjin e buxhetit.			Nuk janë marrë masa.

3.5.2 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të sigurojë që në bashkëpunim me Ministrin e Financave kanë shqyrtuar mundësinë e transferit të buxhetit për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike për rastet sociale dhe familjet e dëshmorëve në MPMS. Skemat e rasteve sociale janë aktivitet i MPMS dhe përgjegjësia për administrimin e këtyre listave i takon kësaj ministrie. Më tutje, transferi i mjeteve tek NP të bëhet në përputhje me afatet kohore të parapara me marrëveshjet.	Po		
3.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo- kapitale	Ministri duhet të sigurojë se regjistri i pasurisë pasqyron vetëm pasuritë të cilat i përmbushin kriteret për regjistrimin e tyre. Më tutje, shfrytëzimi i automjeteve jashtë orarit të punës është bërë vetëm pas një aprovimi paraprak nga vet Ministri. Po ashtu, evidencat lidhur me shfrytëzimin e automjeteve duhet të mbahen nga secili përdorues me qëllim të evitimit të përdorimit të tyre për nevoja jo zyrtare.	Po		

Shtojca IV: Komentet e MZHE-së për të gjeturat e raportit të auditimit

Të gjeturat / çështjet	Pajtohem po / jo	Komentet e OB-së në rast të mospajtitimit	Pikëpamja e ZKA-së
Çështja 2 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Pjesërisht	MZHE ka arritur t'i adresoi ato rekomandime që kanë të bëjnë me përmirësimin e realizimit të buxhetit, rritjen e vlerës së parasë, uljen e shpenzimeve të kategorisë së mallrave dhe shpenzimeve, ngritjen e investimeve kapitale, uljen e shpenzimeve të kategorisë së subvencioneve si dhe listën e pasurisë të MZHE-së.	Në komentin e Ministrisë nuk mohohet e gjetura por vetëm jepen shpjegime për progresin gjë të cilën ne e kemi konstatuar në çështjen 2 dhe shtojcën III ku kemi sqaruar për secilin rekomandim të vitit paraprak nëse është adresuar ose jo. Prandaj rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.
Çështja 5 - Realizimi i ulët i buxhetit për Investime kapitale	Pjesërisht	Ky projekt është i një dimensionimi më të gjerë dhe në këtë rast janë të ndërthurur shumë faktor jashtë MZHE-së, siç është Banka Botërore. MZHE ka ndërmarrë një seri veprimesh për ta realizuar në tërësi masën monetare të paraparë për vitin 2016 po për shkak të procedurave dhe kundërshtimeve që kanë ndodhur në procesin e tenderimit ka ardhur deri te shtyrja e projektit dhe mos realizimi i projektit sipas ligjit që është ratifikuar në Kuvend.	Në komentin e Ministrisë nuk mohohet e gjetura por vetëm jepen shpjegime të njohura për ne që edhe i kemi prezantuar në draft raport. Meqenëse nuk është ofruar ndonjë argument shtesë rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.

Çështja 8 – Pagesa e subvencionit nuk është në përputhje me marrëveshjen	Pjesërisht	Pagesa është në përputhje me ndarjen buxhetore me Ligjin e buxhetit për vitin 2016 dhe është në kategorinë dhe programin e Ujit dhe Hedhurinave, program në të cilin bëjnë pjesë të gjitha Ndërmarrjet Publike që trajtojnë këto dukuri. Mungesa e shkresës nga NJPMNP në dosjen e pagesës nuk ka ndikuar në ligjshmërinë e pagesës dhe si e tillë mund të trajtohet si efekt teknik dhe në asnjë mënyrë si çështje "E gjetur me prioritet të lartë" siç është cilësuar në draft raportin e auditimit të PFV 2016.	Në komentin e Ministrisë nuk mohohet e gjetura por vetëm jepen shpjegime të njohura për ne që edhe i kemi prezantuar në draft raport. Po ashtu kjo çështje në draft raport është me prioritet të mesëm e jo siq theksohet nga MZHE se është me prioritet të lartë. Meqenëse nuk është ofruar ndonjë argument shtesë rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.
Çështja 9 – Kriteret e vendosura në dosje të tenderit	Jo	E gjetura e auditorit nuk qëndron për shkak se në dokumentacionin e dosjes së tenderit, të cekur në çështjen 9, ka qenë raporti i pasqyrave financiare për vitin 2014. Bashkëlidhur keni edhe dëshmitë që saktësojnë këtë konstatim.	Kjo e gjetur ka pasur brenda vetes dy çështje të trajtuara, kështu që për këtë koment të ofruar nga MZHE neve na është ofruar dëshmia dhe ne e kemi ndryshuar kurse pjesa tjetër e të gjeturës për të cilën MZHE ishte pajtuar ka mbetur e pa ndryshuar.

Shtojca V: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Ministarstvo Ekonomskog Razvoja / Ministry of Economic Development			
Mbrojtje Org. Org. Unit	02	M. Prist. Prisht. No.	1210
No. i Dokumentit No. Doc.	10	Data e Dokumentit Date	22.06.17
PRISHTINË			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Ministarstvo Ekonomskog Razvoja,
Ministry of Economic Development

Për: z. Valbon Bytyqi,
Ndihmës Auditor i Përgjithshëm – Zyra Kombëtare e Auditimit;

znj. Emine Fazliu,
Udhëheqëse e Departamentit të Auditimit - Zyra Kombëtare e Auditimit

Cc: Blerand Stavileci,
Ministër, Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Nga: Nazmi Zenelaj,
Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Agim Thaci,
Drejtor i DFSHP, Ministri e Zhvillimit Ekonomik

Tema : LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

E/! nderuar,

Prishtinë, 22 Qeshor 2017

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kemi pranuar draft-raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti").

- Pas shqyrtimit të draft raportit në takimin e zhvilluar me datën 21.06.2017 me zyrtaret e njësive përkatëse dhe përfaqësuesve të ZKA-se, konfirmojmë pajtimin për rekomandimin 1 – Çështja 3, Çështja 4, Çështja 6, Çështja 7 dhe Çështja 10.

Ndërsa pajtim të pjesshëm kemi për Çështjen 2, Çështjen 5, Çështja 8.

Gjithashtu nga takimi është konstatuar nga përfaqësuesit e ZKA-se, se Çështja 9 nuk do të jete e pjese e RAPF për vitin 2016, ngase janë prezantuar dëshmitë mjaftueshme ligjore.

- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Bashkangjitur keni komentet në draft raportin RAPFV.

Ju falënderojmë paraprakisht për bashkëpunimin tuaj.